



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 10

Prishtinë, më 6.6.2011, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Afërdita Berisha-Shaqiri, Sevdije Lama, Nijazi Idrizi, Etem Arifi dhe Salih Morina.

Mungoi : Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: Shefki Kastrati (NDI), Lejla Selimi (OSBE), UNDP zyrtarë, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës.**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit dt. 2.6.2011,**
- 3. Takimi me Ministren Mimoza Kusari-Lila,**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 2.6.2011 nr. 9

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 2.6.2011 pa vërejtje.

3. Takimi me Ministren Mimoza Kusari-Lila

Kryetari Nait Hasani në fillim falënderoi ministren znj. Kusari në përgjigje të ftesës dhe njoftoi atë se çështjet aktuale në komision kanë shtyre për ta ftuar në këtë komision, sidomos gjatë vizitave nëpër komuna të komisionit ku është pa nevoja për mbrojtjen e produkteve të vendit përkatësisht të fermerëve tanë.

Ministrja **Mimoza Kusari** gjithashtu falënderoj për bashkëpunim dhe vërtetoj synimet e kryetarit për faktin se Qeveria tani e tutje e ka shpallur bujqësinë primare për zhvillimin ekonomik të vendit duke synuar për çdo vit shkallë shkallë të ritën të hyrat buxhetore për bujqësi gjithnjë duke favorizuar stimulimin e fermerëve vendor, marrëveshjet për tregtinë e lirë etj. Në kuadër të CEFTËS janë marr masat për mbrojtjen e mallrave sidomos të grurit, edhe poqes nuk importohet nga Serbia (ajo rikujtoi se CEFTËN e ka nënshkruar UNMIKU), janë vendosur masat doganore për shkak të mospranimi të vulave (nëse vazhdon kështu do të pasoj bllokada e tërësishme), në anën tjetër ne kemi mullinj për kapacitetin e 8 milion banorëve, prandaj në këtë drejtim nuk duhet të jemi të brengosur, sepse mund të importojmë edhe nga shtetet tjera. Problemi tjetër është qumështi, vazhdoi ajo, ku Republika e Shqipërisë, për çudi, kërkon çmime referente, të cilat ne nuk i kërkojmë nga ata, mirëpo lidhur me këtë problem ajo ka kërkuar takim me ministrin përkatës në Shqipëri. MTI është e përkushtuar për mbrojtjen e prodhimeve vendore duke i mbrojtur ato në krahasim me mallrat nga jashtë, sidomos në aspektin fiskal, në mënyrë që prodhimi vendor mos të ngarkohet 26% ende pa u prodhuar. Ajo në vazhdim me shembuj të ndryshëm ilustron atë çka e tha paraprakisht. **Nait Hasani** tha se mallrat në bujqësi nuk kanë mundësi të konkurrojnë në treg, ndërsa **Liburn Aliu** pyeti si do të mbrohet popullata në rast të bllokadës së mallrave nga Serbia, me taksë doganore e cila është në kundërshtim me CEFTËN, me dalë nga CEFTA apo si. Gjithashtu ai pyeti për mundësinë e vendosjes së doganës për Malin e Zi p.sh. për verërat përkundër faktit që vena e tyre subvencionohet nga shteti, në mënyrë që prodhimi ynë të plasohet në treg. Ministrja tha se gjatë importimit importohen, përveç verës : shishja, tapa etj, por është me rëndësi të ngritët kualiteti i prodhimit me këto masa doganore. **Afërdita Berisha** pyeti sa është përqindja e produkteve të Serbisë në përgjithësi dhe a do të rritet çmimi i produkteve zëvendësuese, si dhe në këto mallra nga Serbia a përfshihen edhe ato medicinale. Ministrja tha se 15% e mallrave në vit janë nga Serbia dhe Bosnja (Bosnja më tepër importon). Ajo edhe një herë përsëriti se deri te bllokada mund të vjen për shkak të ndalimit të kontrabandimit në veri, për çka kërkohet prezenca e EULEX në kufijtë e veriut. Dmth çmimi do të rritet për ata që dëshirojnë produktet serbe. Edhe mallrat medicinale bëjnë pjesë në këto mallra nga Serbia. Në pyetjen se a ekziston lista e produkteve, ajo u përgjigj se ato janë gruri, sheqeri, vaji, letra për ambalazhim. Mirëpo brengat janë hequr pasi që kanë filluar bisedimet me tregtar tjerë nga Maqedonia etj.

Sevdije Lama pyeti për biznese dhe marrjen e licencave si dhe a ka mundësi të promovohet edhe prodhimi vendor në mënyrë që të shihet se edhe ne prodhojmë cilësi të mirë, për çka ministrja tha se ato kanë filluar të eliminohen së pari në dy dikastere, në Agjencitë turistike dhe për ndërtime, pasi që kriteret duhet të kërkojnë në momentin e regjistrimit. Dmth synohet kategorizimi i tyre ABC etj. me çka ngritët llogaridhënia ndaj shtetit, ndërsa për promovimin e prodhimit tha se mund të ketë kundërefektin, prandaj me marketing mirën kompanitë e veçanta (Devolli). **Nait Hasani** pyeti sa janë importues të derivateve të naftës, për çka ministrja tha se janë dy kategori 1. ato me depo të mëdha dhe 2. importues të vegjël, mirëpo nuk u deklarua se a është gabimi i ish ministrit që ka licencuar të gjithë (më gjerësisht ajo sqaroi çështjet me OKTËN e Maqedonisë e cila përcakton çmimin për derivatet tona). **Nijazi Idrizi** u interesua për Ligjin për mbrojtjen e konsumatorit, për TVSH në dogana, si të çasemi CEFTËS dhe certifikimin. Përgjigjet ishin se mbrojtja e konsumatorëve do të varet nga aktiviteti i inspektoriatit, ndërsa për përgjegjet tjera tha se varet nga ngritja e kualitetit të prodhimeve. **Etem Arifi** falënderoj ministren në pjesëmarrjen në këtë mbledhje si dhe për përgjegjet që u dhanë. **Rasim Demiri** u interesua për certifikime hallall nga Bosnja ku krijohen probleme me Republikën Serbe, mirëpo ministrja tha se ende nuk janë mar masa obligatore. **Liburn Aliu** pyeti për AVUK a po mundet

me realizua obligimet pas riorganizimit që kishte sa i përket kontrollit të ushqimit dhe a ka raporte të publikuara nga kjo agjenci, ndërsa për Bechtel Enkën pyeti a ka ndonji nen që ja lejon punën pasi që ka filluar pa licencim. Ministria tha se AVUK-un e mbikëqyr zv.krm. Bujar Bukoshi dhe shtoi se laboratorët aty funksionojnë duke kryer analizat e duhura. Ushqimi testohet 20%, ndërsa analizat bëhen nëse ka dyshim të bazuar p.sh. mishi i pulës para disa ditësh ka qenë i dyshimt, nesër do të shkohet të konstatohet në doganë. Lidhur me Bechtel Enka tha se është vonuar por më vonë ka marr licencën, por më tutje ajo nuk ishte e sigurt për të përgjegjur ngase duhet të verifikohen faktet. **Afërdita Berisha** pyeti si mund të ndalet konkurrenca e produkteve nga Maqedonia, përgjigja ishte vetëm me futjen e barrierave jotarifore.

Qëllimi kryesor, vazhdoi ministria, i aplikimit të masave doganore është zëvendësimi i produkteve nga jashtë me ato vendore dhe ndalimi i falsifikimit dhe kontrabandimit në veri, zbulimi i masave antidamping etj (është formuar komisioni për të verifikuar se a ka bërë shteti damping të një produkti). Më 2012 Kosova do të ketë më tepër të hyra në Bujqësi, njëkohësisht kjo do të shërbejë si fushatë për BE-në dhe Turqinë ngase marrëveshja e CEFTËS me Kosovën duhet të jetë formale e jo sipas 1244-shit. Në fund ajo sugjeroi të ftohet për një takim tjetër lidhur me Ligjin për Rezervat Shtetërore i cili ligj ka implikime ligjore përkatësisht duhet të bëhen analizat e mëtejshme. Kryetari falënderoi në emër të komisionit.

4. Të ndryshme

1. Në këtë pikë **Kryetari Nait Hasani** propozoi të shqyrtohet Plan Hapësinor i Kosovës 2011-2020 ashtu si paralajmëroi në takimin e fundit, ndaj kërkoi sqarimet e duhura nga zyrtarët e MMPH.

Arben Qitaku, Luan Nushi dhe Remzush Latifi nga MMPH shkurtimisht njoftuan komisionin se ky plan paraqet abecedën e planifikimit hapësinor në Kosovë i cili tanimë ka fituar formën e fuqizuar përveç votës së Kuvendit të Kosovës, ngase obligon komunat dhe sipas këtij plani kanë punuar të gjitha komunat e Kosovës duke harmonizuar me planet lokale. Disa herë është dërguar dhe kthyer nga komunat për të plotësuar atë. Ky plan është profit i një procesi të tërë, ngase është përkrahë nga sektorët e ndryshëm institucional të Qeverisë, ku ka pasur konflikte ato janë eliminuar dhe është hera e tretë që shkon në Qeveri, por edhe në Kuvend. Në pyetjen e **Nijazi Idrizit** zyrtarët e MMPH vërtetuan se ky plan në esencë është për të mbrojtur tokën bujqësore, ndërsa në pyetjet lidhur me Prevallën, zonat e mbrojtura etj përgjigja ishte se për ato në veçanti do të krijohen planet e veçanta. **Sevdije Lama** pyeti për planet urbanistike a janë të harmonizuara me këtë plan dhe sa janë profesioniste ato, ndërsa Arben Qitaku tha se planet komunale, niveli i planeve urbane dhe planet rregullative urbane në tërësi janë harmonizuar me këtë plan, ndërsa për pjesën tjetër të pyetjes tha se vlen licencimi i ingjinerëve të kësaj lëmie që bëhen në këtë ministri. Ky dokument përmban atributet për miratim ngase është dokument i gjallë i kryer, poqes ndryshohet do të pasoj edhe aneksi lidhur me atë ndryshim. **Afërdita Berisha** pyeti për bashkëpunimin me komuna gjatë hartimit të planit, ndërsa përgjigja ishte se në fund të çdo faze ka pas bashkëpunim përmes debateve publike. **Libur Aliu** pyeti për “Ahtisarin” sa është involvua në këtë plan në aspektin hapësinor. Arben Qitaku tha se të gjitha ato komuna të “Ahtisarit” janë vetdijësuar për këtë plan, ky plan p.sh. nuk vlen për Hoçën e Madhe ngase atë zonë thjesht ky plan nuk e ka përfshi por më vonë do të hartohet plani i veçantë, ngase ky dokument është i vijave të trasha. **Salih Morina** u interesua për planin a do të ketë implikime buxhetore, për çka përgjigja ishte se nuk do të ketë por ato do të përfshihen veç e veç për çdo komunë.

Kryetari konstatoi se Komisioni me konsensus nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni miraton Planin Hapësinor të Kosovës 2011-2020.
- II. Arsyetimin para Kuvendit do të paraqet Nait Hasani, kryetar i komisionit.

2. Kryetari **Nait Hasani** reagoi në shkrimin e gazetës “Kosova Sot” datës 3 qershor 2011 e cila duke komentuar mbledhjen e këtij komisioni nga dt. 2 qershor 2011 ka shkruar “komisioni me vështirësi arriti të verifikoj ekspertët për projektligje” si dhe “një ekspert do ti paguhet dita 100 euro”. Komisioni u pajtua lidhur me këtë :

KONKLUDIM

Ky komision falënderon mediet për transparencë dhe pjesmarrje në punën e komisionit por kërkon korrektësi gjatë publikimit nëpër gazetat tona të përditshme, ngase është e kundërta e publikimit : Komisioni në atë mbledhje shumë lehtë ka zgjedhur ekspertët përkatës, ndërsa 100 euro nuk është e sakt se paguhet një ditë eksperti nga ky komision.

3. Lidhur me Projektligjin për verëra i cili ishte në leximin e parë më 3 qershor, **kryetari Nait Hasani** propozoi, ndërsa komisioni nxori këtë :

PËRFUNDIM

Formohet grupi punues për këtë projektligj në përbërje : Nait Hasani-kryesues, Daut Haradinaj dhe Afërdita Berisha.

Mbledhja përfundoi në orën 13,05, ndërsa komisioni vazhdoi në vizitën tek Ministria e Bujqësisë.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani**
